



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1240/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Muhamet Lladrovci kandidate për anëtare të asamblesë komunale nga (PDK), dega në Drenas, paraqitur kundër Komisionit Qëndror Zgjedhor (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor dhe manipulimit të votave në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

#### VENDIM

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Muhamet Lladrovci kandidate për anëtarë të asamblesë komunale në Drenas nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

**Urdhërohet** KQZ-ja që të rinumëroj fletëvotimet në Vendvotimin 0316E / 01R, vetëm sa ju përket kandidatit të sipërshënuar dhe rezultati të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të 3 Nëntorit 2013.

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Muhamet Lladrovci kandidate për anëtare të asamblese komunale dega në Malishevë, në të cilën pretendon se në Qendrën e Votimit në shkollën fillore Xhevë Lladrovci në fshatin Gllanasellë në vendvotimin me numër 0316E/01R, sipas procesverbalit në FRK ka marrë 180 vota, ndërsa sipas QNR-së rezultojn të ketë 128 vota.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

## **Ankesa është e bazuar**

PZAP-i nga shkresat e lëndës të ofruara nga pala ankuese si dhe nga shqyrtimi dhe hetimi i bërë në materialin zgjedhor dyshon në mungesën e votave të kandidatit në fjalë për vendvotimin e lartcekur në dispozitiv dhe në mospërputhje të rezultateve me ato të publikuara nga KQZ për kandidatin në fjalë. PZAP-i në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në këtë vendvotim. Andaj PZAP nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura si dhe në mbështetje të 117.4 lidhur me nenin 118.1 dhe 119.5 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 1240/2013 më datën 06.12.2013



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24( njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.